



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

VENDIM

Nr 20 Datë 27/07/2016

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES ME AERONAUTIKËN SHQIPTARE PËR
DHËNIEN NË PËRDORIM TË VELËS SË BRANDUAR ME LOGON E RE TURISTIKE TE
QARKUT VLORE, PER FLUTURIMET SPORTIVE "PARAGLIDING" ME QËLLIM
PROMOVIMIN E IMAZHIT TURISTIK TE QARKUT VLORË**

Këshilli i Qarkut Vlorë , në mbledhjen e datës ___/07/2016 , në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 "PËR VETËQEVERISJEN VENDORE", neni Neni 77 pika e), ligji 10 296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" VKM 773 dt.14.11.2007 "Për miratimin e strategjise se zhvillimit rajonal" pika 83, urdherit te Ministrit te Financave nr.8980 dt. 15.07.2010 "Per miratimin e Manualit per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), udhezimit te Ministrise se Financave nr.30 dt.27.12.2011 "Per menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik" (i ndryshuar)" si dhe në mbështetje të vizionit të Institucionit për promovimin e imazhit turistik të qarkut Vlorë si një destination i rëndësishëm turistik dhe duke synuar rritjen e impaktit të këtij imazhi tek turistët që vizitojnë qarkun tonë. Pasi mori në konsideratë dhe propozimin e Aeronautikës Shqiptare për të ofruar mbeshtetjen e saj për të bërë të mundur promovimin e imazhit të ri zyrtar të turizmit për Qarkun Vlore, nëpërmjet fluturimeve që kryejnë sportistët e kësaj federate gjithandej në Shqipëri, por kryesisht ne Qarkun tone:

VENDOSI

- 1) Miratimin e marrëveshjes me Aeronautikën Shqiptare për dhënie në përdorim të velës së branduar me logon e re turistike te Qarkut Vlorë, për fluturimet sportive "paragliding" me qëllim promovimin e imazhit turistik të Qarkut Vlorë
- 2) Për lidhjen e marrëveshjes dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut.
- 3) Ky vendim hyn ne fuqi sipas ligjit nr. 139/2015, date 17.12.2015 neni 78 pika 3.



SADRIT DANAJ
KRYETARI